

VENDIM
Nr. 856, datë 4.11.2020

**PËR NDIHMËN FINANCIARE TË DISA PREJ KATEGORIVE KRYESORE TË
NDËRMARRJEVE, TË CILAT ZBATOJNË PROTOKOLLET E SIGURISË, NË
KUADËR TË PARANDALIMIT E TË KONTROLLIT TË PANDEMISË COVID-19**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 11 e 17, të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, dhe të pikës 5, të nenit 41, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim synon dhënien e ndihmës financiare për ndërmarrjet e kategorizuara të vogla dhe të mesme në sektorin e prodhimit (në vijim “ndërmarrjet”), sipas nenit 4, të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, të ndryshuar, sipas kodeve REV 2 NACE, në aneksin nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ndihma financiare shtrihet për periudhën nëntor–dhjetor 2020 dhe u jepet ndërmarrjeve për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve, për të zbatuar protokollin, në kuadër të pandemisë COVID-19, bazuar në numrin e të punësuarve.

3. Skema jep ndihmë financiare të drejtpërdrejtë për ndërmarrjet, që të mbulojë një pjesë të shpenzimeve, për të zbatuar protokollin, në kuadër të pandemisë COVID-19, bazuar në numrin e të punësuarve.

4. Skema mbështetëse llogaritet e jepet për ndërmarrjet, të punësuarit e të cilave figurojnë në listëpagesat e përditësuara të tatimpaguesit, për muajin qershor 2020, të dorëzuara përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Ndërmarrja për çdo të punësuar në më tepër se një listëpagesë përfiton vetëm një herë ndihmën financiare, sipas këtij vendimi. Në rastet kur i punësuar është në më tepër se një listëpagesë dhe kontributet paguhen nga të dyja ndërmarrjet, ndihmën financiare e merr ndërmarrja, e cila aplikon e para. Ndërmarrja që nuk aplikon e para, nuk e përfiton ndihmën financiare vetëm për të punësuarin që është në më tepër se në një listëpagesë. Nuk konsiderohen të punësuar individët e deklaruar me 0 (zero) lekë në listëpagesë.

6. Ndërmarrjeve u jepet si ndihmë financiare një shumë fikse, në masën 4 000 (katër mijë) lekë për çdo punonjës, e llogaritur për dymujorin nëntor–dhjetor 2020, respektivisht 2 000 (dy mijë) lekë për çdo muaj.

7. Nuk përfitojnë nga ndihma financiare ndërmarrjet, të cilat nuk rezultojnë aktive në datën e hyrjes në fuqi të vendimit e që nuk kanë dorëzuar deklaratë vjetore për vitin 2019 (tatim i fitimit ose tatim i thjeshtuar mbi fitimin).

8. Aplikimi për përfitimin e ndihmës financiare kryhet nga ana e ndërmarrjeve në sistemim *e-filling*, duke deklaruar:

- a) NIPT-in e përfituesit;
- b) numrin total të punonjësve për të cilët përfiton subjekti;
- c) bankën, ku përfituesi ka llogarinë rrjedhëse bankare;
- ç) IBAN-in e llogarisë bankare.

9. Me qëllim shmangien e abuzimit, strukturat e administratës tatimore, duke përdorur analizën e riskut, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e aplikimit, mund të kryejnë edhe verifikime të ndërmarrjeve përfituese, nëse përmbushen kriteret. Lista e ndërmarrjeve përfituese publikohet në *website*-in e administratës tatimore.

10. Në zbatim të legjislacionit ekzistues, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve i paraqet Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit (strukturës përgjegjëse për thesarin në degë) dokumentacionin përkatës për kryerjen e pagesave të detajuara, sipas bankave të nivelit të dytë, të cilat i informon për listën/listat e ndërmarrjeve përfituese të skemës mbështetëse, me të dhënat e mëposhtme:

- a) NIPT-in e përfituesit;
- b) numrin total të punonjësve për të cilët përfiton subjekti;
- c) bankën, ku përfituesi ka llogarinë rrjedhëse bankare;
- ç) IBAN-in e llogarisë bankare.

11. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, në zbatim të procedurave ekzistuese, menjëherë, me paraqitjen e urdhërshpenzimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kryen pagesat në total për çdo bankë të nivelit të dytë dhe kjo e fundit, bazuar në listën përmbledhëse të mësipërme të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kryen transfertat në llogaritë bankare të ndërmarrjeve përfituese sipas këtij vendimi.

12. Ndihma financiare për ndërmarrjet përfituese mbulon periudhën nëntor–dhjetor 2020 dhe përfitohet vetëm një herë si shumë e vetme.

13. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, deri në masën 187 092 000 (njëqind e tetëdhjetë e shtatë milionë e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë, përballohen nga zëri “Nxitja e punësimit”, në programin 10550, “Tregu i punës”, në buxhetin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, miratuar për vitin 2020.

14. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

ANEKS NR. 1
KODET REV 2 NACE

C2452	Derdhja (fonderia) e çelikut
C2451	Derdhja (fonderia) e gizes
C2453	Derdhja (fonderia) e metaleve të lehta
C2454	Derdhja (fonderia) e metaleve të tjera joferrike
C2312	Dhënia e formës dhe transformimi i qelqit të sheshtë
C1101	Distilimi, rektifikimi dhe kombinimi i pijeve
C1320	Endja e tekstileve
C2311	Fabrikimi i qelqit të sheshtë
C2550	Farkëtimi, kovaçana, stampimi dhe petëzimi, pluhuri metalurgjik
C1431	Konfeksionimi i trikotazheve me thyesa
C1411	Konfeksionimi i veshjeve prej lëkure
C1414	Konfeksionimi i veshjeve të brendshme
C1412	Konfeksionimi i veshjeve të punës
C1419	Konfeksionimi i veshjeve të tjera dhe aksesorë
C1413	Konfeksionimi i veshjeve të tjera të jashtme
C1439	Konfeksionimin e veshjeve të tjera me thyesa
C1814	Lidhja dhe shërbime të lidhura me të
C3011	Ndërtimi i anijeve dhe i strukturave lundruese
C3012	Ndërtimi i barkave të argëtimit dhe sportive
C1310	Përgatitja e fibrave tekstile dhe filatura
C1086	Përgatitja e ushqimeve të homogjenizuara dhe ushqimeve dietetike
C1031	Përpunimi dhe konservimi i patates
C1020	Përpunimi dhe konservimi i peshkut, krustaceve dhe molusqeve
C2030	Përpunimi i bojërave, vernikëve dhe shtresave të ngjashme, bojë shkrimi dhe mastiç

C1083	Përpunimi i çajit dhe i kafesë
C2051	Përpunimi i eksplozivëve
C2060	Përpunimi i fibrave sintetike dhe artificiale
C2017	Përpunimi i kauçukut sintetik në formë primare
C1032	Përpunimi i lëngut të frutave dhe i perimeve
C2016	Përpunimi i materialeve plastike në formë primare
C2446	Përpunimi i metaleve nukleare
C2052	Përpunimi i ngjitësve
C2042	Përpunimi i parfumeve dhe i solucioneve të tualetit
C2020	Përpunimi i pesticideve dhe i produkteve të tjera agrokimike
C2120	Përpunimi i preparateve farmaceutike
C2110	Përpunimi i produkteve farmaceutike bazë
C1061	Përpunimi i produkteve të drithërave
C1910	Përpunimi i produkteve të furrës së koksit
C1051	Përpunimi i produkteve të qumështit
C1920	Përpunimi i produkteve të rafinerisë së naftës
C2014	Përpunimi i produkteve të tjera kimike me bazë organike
C2059	Përpunimi i produkteve të tjera kimike p.k.t.
C2041	Përpunimi i sapunëve dhe i detergjenteve, solucioneve të pastrimit dhe shkëlqimit
C1091	Përpunimi i ushqimeve të përgatitura për kafshët e fermës
C1092	Përpunimi i ushqimeve të përgatitura për kafshët shtëpiake
C1041	Përpunimi i vajrave dhe yndyrave
C2053	Përpunimi i vajrave esenciale
C2432	Petëzimi në të ftohtë i rripave
C3211	Prerja e monedhave
C1039	Procese të tjera përpunimi dhe konservimi të frutave dhe i perimeve
C1330	Procese përfundimtare të përpunimit të tekstileve
C1011	Prodhimi dhe përpunimi i mishit
C1012	Prodhimi dhe përpunimi i mishit të shpendëve
C2319	Prodhimi dhe transformimi i qelqeve të tjera, duke përfshirë qelqin teknik
C1052	Prodhimi i akullores
C2352	Prodhimi i allçisë dhe gëlqeres
C2442	Prodhimi i aluminit
C2592	Prodhimi i ambalazheve prej metali të lehtë
C2751	Prodhimi i aparateve shtëpiake elektrike
C2712	Prodhimi i aparaturave të shpërndarjes dhe të kontrollit të energjisë elektrike
C2540	Prodhimi i armëve dhe i municioneve
C1722	Prodhimi i artikujve prej letre me përdorim familjar dhe sanitar, letrës së tualetit
C2341	Prodhimi i artikujve prej qeramike për përdorim shtëpiak dhe zbukurues
C3230	Prodhimi i artikujve të sportit
C2369	Prodhimi i artikujve të tjerë prej betoni, allçie dhe çimento
C1729	Prodhimi i artikujve të tjerë prej letre dhe kartoni të p.k.t.
C1392	Prodhimi i artikujve tekstilë të konfeksionuar, përveç veshjeve
C2444	Prodhimi i bakrit
C2720	Prodhimi i baterive dhe akumulatorëve
C2611	Prodhimi i bazamenteve elektronike
C2363	Prodhimi i betonit të përzier të gatshëm për përdorim
C3092	Prodhimi i biçikletave dhe i karrocave të invalidëve
C1105	Prodhimi i birrës
C1072	Prodhimi i biskotave dhe i galetave; prodhimi i pastave dhe kekëve të konservuar
C1711	Prodhimi i brumit të letrës
C1071	Prodhimi i bukës; prodhimi i pastave të freskëta dhe kekëve
C2351	Prodhimi i çimentos
C2529	Prodhimi i cisternave të tjera, rezervuarëve dhe mbajtësve prej metali
C2594	Prodhimi i dadove dhe i bulonave
C2512	Prodhimi i dyerve dhe i dritareve metalike
C3103	Prodhimi i dyshekëve
D3511	Prodhimi i energjisë elektrike
C1084	Prodhimi i erëzave dhe salcave

C2314	Prodhimi i fibrave të qelqit
C3291	Prodhimi i fshesave dhe i furçave
C2821	Prodhimi i furrave, furnaltave dhe aparaturave për djegie
C2011	Prodhimi i gazit industrial
C2530	Prodhimi i gjeneratorëve të avullit, përveç bolierëve me ujë të ngrohtë për ngrohje qendrore
C2211	Prodhimi i gomave dhe i kamerdareve, riveshja dhe rikonstruktimi i gomave dhe kamerdareve
C2651	Prodhimi i instrumenteve dhe i aparateve për matje, verifikim, kontrolle
C3250	Prodhimi i instrumenteve dhe i pajisjeve mjekësore dhe dentare
C2670	Prodhimi i instrumenteve dhe i pajisjeve optike
C3220	Prodhimi i instrumenteve muzikore
C2841	Prodhimi i instrumenteve për punimin e metaleve
C2849	Prodhimi i instrumenteve të tjera p.k.t.
C2343	Prodhimi i izolatorëve qeramikë dhe i pajisjeve izoluese
C1082	Prodhimi i kakaos, çokollatës dhe i ëmbëlsirave
C1623	Prodhimi i karpentierëve të ndërtuesve dhe të zdrukthëtarive
C2920	Prodhimi i karrocërive për mjetet e transportit: prodhimi i rimorkiove dhe gjysmërimorkiove
C1520	Prodhimi i këpucëve
C2013	Prodhimi i kimikateve të tjera me bazë inorganike
C1621	Prodhimi i kompensatës, rimesos dhe paneleve të veçanta
C2620	Prodhimi i kompjuterave dhe i pjesëve periferike
C1624	Prodhimi i kontejnerëve prej druri
C2591	Prodhimi i kovave me çikrik prej çeliku dhe mbajtës të tjerë të ngjashëm
C2815	Prodhimi i kushinetave, ingranazheve, grupeve të ingranazheve dhe elementet e drejtimit
C2572	Prodhimi i kyçeve dhe i menteshave
C1712	Prodhimi i letrës dhe i kartonit
C1721	Prodhimi i letrës dhe i kartonit të zhubrosur dhe ambalazhit të letrës dhe kartonit
C1724	Prodhimi i letrës së murit
C1723	Prodhimi i letrës së zakonshme të palëvizshme
C1394	Prodhimi i litarëve, spangove dhe rrjetave
C2364	Prodhimi i llaçit
C3240	Prodhimi i lojërave dhe i lodrave
C3020	Prodhimi i lokomotivave dhe mjetet mbështetëse të transportit hekurudhor
C1073	Prodhimi i makaronave
C2830	Prodhimi i makinerive bujqësore dhe pyjore
C2823	Prodhimi i makinerive dhe i pajisjeve të zyrave, përveç kompjuterave dhe pajisjeve periferike
C2892	Prodhimi i makinerive për industrinë nxjerrëse dhe ndërtim
C2891	Prodhimi i makinerive për metalurgjinë
C2893	Prodhimi i makinerive për përpunimin e ushqimeve, pijeve dhe duhanit
C2895	Prodhimi i makinerive për prodhimin e letrës dhe të kartonit
C2894	Prodhimi i makinerive për prodhimin e tekstileve, veshjeve dhe lëkurëve
C2896	Prodhimi i makinerive të plastikës dhe i kauçukut
C2899	Prodhimi i makinerive të tjera me përdorim të përgjithshëm p.k.t.
C2829	Prodhimi i makinerive të tjera me përdorim të përgjithshëm të p.k.t.
C2223	Prodhimi i mallrave plastike për ndërtim
C2222	Prodhimi i mallrave të paketimit prej plastike
C1106	Prodhimi i maltës
C1042	Prodhimi i margarinës dhe i yndyrave të tjera të ngjashme
C2441	Prodhimi i metaleve të çmuara
C2445	Prodhimi i metaleve të tjera joferrike
C2680	Prodhimi i mjeteve të komunikimit optike dhe magnetike
C2910	Prodhimi i mjeteve të transportit
C3102	Prodhimi i mobilieve të kuzhinës
C3109	Prodhimi i mobilieve të tjera
C3101	Prodhimi i mobilieve të zyrave dhe të dyqaneve
C2811	Prodhimi i motorëve dhe i turbinave, përveç motorëve të avionëve, automjeteve dhe motoçikleta
C2711	Prodhimi i motorëve elektrikë, gjeneratorëve dhe transformatorëve
C1103	Prodhimi i mushtit dhe i verërave të tjera me bazë frutash
C2012	Prodhimi i ngjyruësve dhe i pigmenteve
C1062	Prodhimi i niseshtesë dhe i produkteve të niseshtesë

C2740	Prodhimi i pajisjeve elektrike të ndriçimit
C2825	Prodhimi i pajisjeve ftohëse dhe ventiluese joshtëpiake
C2342	Prodhimi i pajisjeve sanitare prej qeramike
C2752	Prodhimi i pajisjeve shtëpiake joelektrike
C2822	Prodhimi i pajisjeve të ngritjes dhe të zhvendosjes
C2790	Prodhimi i pajisjeve të tjera elektrike
C2660	Prodhimi i pajisjeve rrezatuese, elektromjekësore dhe elektroterapiste
C1622	Prodhimi i parketeve për dysheme të montuar
C1395	Prodhimi i pëlhurave të paendura dhe artikujve të paendur, përveç veshjeve
C1104	Prodhimi i pijeve të tjera të fermentuara të padistiluara
C2932	Prodhimi i pjesëve dhe i aksesorëve të tjerë për mjetet e transportit dhe motorët e tyre
C2931	Prodhimi i pjesëve elektrike dhe elektronike për mjetet e transportit dhe motorët e tyre
C2015	Prodhimi i plehrave kimike dhe i komponimeve të azotit
C2443	Prodhimi i plumbit, zinkut dhe kallajit
C2813	Prodhimi i pompave dhe i kompresorëve të tjerë
C2391	Prodhimi i produkteve abrazive
C2640	Prodhimi i produkteve, elektronikave për konsumatorët
C2365	Prodhimi i produkteve me fibrave të çimentuara
C2399	Prodhimi i produkteve minerale jometalike të p.k.t.
C2362	Prodhimi i produkteve prej allçie për qëllime ndërtimi
C2361	Prodhimi i produkteve prej betoni për qëllime ndërtimi
C2593	Prodhimi i produkteve prej teli, zinxhiri dhe sustë
C2320	Prodhimi i produkteve refraktare
C1200	Prodhimi i produkteve të duhanit
C1013	Prodhimi i produkteve të mishit dhe të mishit të shpendëve
C2599	Prodhimi i produkteve të tjera metalike p.k.t.
C2229	Prodhimi i produkteve të tjera plastike
C1629	Prodhimi i produkteve të tjera prej druri; prodhimin e artikujve prej xunkthi, shporte dhe
C2349	Prodhimi i produkteve të tjera prej qeramike
C2344	Prodhimi i produkteve të tjera qeramike teknike
C1089	Prodhimi i produkteve të tjera ushqimore p.k.t.
C2219	Prodhimi i produkteve të tjerë prej kauçuku
C2521	Prodhimi i radiatorëve dhe bolierëve për ngrohje qendrore
C1081	Prodhimi i sheqerit
C3213	Prodhimi i stolive imitacion dhe artikuj të ngjashëm me to
C3212	Prodhimi i stolive të çmuara dhe artikuj të lidhur me to
C2511	Prodhimi i strukturave metalike dhe pjesët e strukturave
C2814	Prodhimi i tapave dhe valvulave
C1393	Prodhimi i tapeteve dhe i qilimave
C1399	Prodhimi i tekstileve të tjera p.k.t.
C1396	Prodhimi i tekstileve të tjera teknike dhe industriale
C1391	Prodhimi i tekstileve të tjera, pëlhurave të endura dhe thurura
C2732	Prodhimi i telave dhe i kabllave të tjerë elektrike dhe elektronike
C2571	Prodhimi i thikave
C2420	Prodhimi i tubave, tubacioneve dhe profilet e lugëta dhe pjesë të tjera prej çeliku
C2331	Prodhimi i tullave dhe i tjegullave prej qeramike
C2332	Prodhimi i tullave, tjegullave dhe produktet e ndërtimit, në argjilë të pjekur
C1512	Prodhimi i valixheve, çantave të dorës dhe të ngjashme, pajimeve të kuajve dhe të tjera
C2573	Prodhimi i veglave
C2824	Prodhimi i veglave portative me motor të inkuorporuar
C1102	Prodhimi i verës nga rrushi
C2221	Prodhimi pllakave, fletëve, tubave dhe profileve prej plastike
C2630	Prodhimin e pajisjeve të komunikimit
C1107	Prodhimin e pijeve të tavolinës; prodhimi i ujit mineral dhe ujërave të tjera në shishe
C1085	Prodhimin e ushqimeve të përgatitura
C2433	Profilizimi në të ftohtë me anë të përkuljes
C1610	Sharrimi dhe zdrukthimi i drurit
C1813	Shërbime të parashtypshkrimit dhe parakomunikimit
C1811	Shtypshkrimi i gazetave

C2410	Siderurgjia, prodhimi i hekurit dhe i çelikut dhe ferroalimizheve
C1511	Tanini dhe regjja e lëkurës dhe ngjyrosja e gëzofit
C2431	Tërheqja në të ftohtë e shufrave
C2370	Thyerja e gurit, dhënia e formës dhe finicioni
C2434	Trafilimi në të ftohtë i telave